



DEKLARATË E PËRBASHKËT

DREJT SË ARDHMES: UDHËZIME PËR SISTEME SHKENCORE TË PËRMIRËSUARA

KONFERENCA II E PËRBASHKËT SHKENCORE
PROCESI I BALLKANIT PERËNDIMOR / PROCESI I BERLINIT
Vjenë · Austri · 22 – 24 maj 2016

Konferenca II e Përbashkët Shkencore e Procesit të Ballkanit Perëndimor u mbledh pranë Akademisë Austriake të Shkencave në Vjenë për të vijuar procesin e nisur në Gjermani në korrik 2015. Rezultatet e Konferencës I të Përbashkët Shkencore janë përmbledhur në një deklaratë të përbashkët. Konferenca II e përbashkët shkencore u përqendrua te përmirësimi i sistemeve shkencore, kërkimore dhe të arsimit të lartë në Ballkanin

Perëndimor në dritën e integritimit në Bashkimin Evropian (BE), me theksin në tri fusha diskutimi:

1. ndryshimi i institucioneve dhe sistemeve,
2. sigurimi i cilësisë në fushat e ndryshme dhe
3. ide konkrete për vënien në zbatim të ndryshimeve pozitive.

Rekomandimet më kryesore

1. Të krijohet një kulturë shoqërore dhe politike që e vlerëson rëndësinë që ka shkenca për një shoqëri të hapur dhe zhvillim ekonomik. Të angazhohen shkencëtarët në vendimmarrjen për politikat dhe të institucionalizohet komunikimi nëpërmjet krijimit të këshillave kombëtarë këshillimorë për shkencën ose të organizmave të ngjashëm.
2. Të përdoren kriteret ndërkombëtare të cilësisë në vlerësimin dhe marrjen në punë dhe të angazhohen shkencëtarë ndërkombëtarë në këto procese.
3. Të përqafohet një kulturë që i mirëpret dhe i tërheq studiuesit e shkëlqyer nga diaspora dhe bashkësia shkencore ndërkombëtare. Të garantohet siguria planifikuese afatgjatë. Të ofrohen masa lëvizshmërie për qarkullimin e trurit në të gjitha nivelet e karrierës.
4. Të krijohen institucione autonome kombëtare për financimin e punës kërkimore dhe të depolitizohet sistemi i shkencave.
5. Të miratohen instrumente të posaçme në kuadër të Horizon 2020 për BP6¹ dhe BE13² për të luftuar pabarazitë në BE dhe për të zhvilluar një nyje qendrore të shkëmbimit të informacionit për mundësitë e financimit nga BE-ja.

1 Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Kosova*, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia. (* Ky emërtim nuk cenon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën nr. 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe me Opinionin e GjND-së "Për deklaratën e pavarësisë së Kosovës".)

2 Vendet që janë bërë Shtete Anëtare të BE-së në vitet 2004, 2007 dhe 2013.

Ndryshimi i sistemeve dhe institucioneve për përmirësimin e sistemeve shkencore

Shkenca në politikë dhe në shoqëri

Në Ballkanin Perëndimor është e nevojshme **të njihet rëndësia që ka shkenca për zhvillimin e vendit**. Shkenca, kërkimi shkencor dhe arsimit i lartë, në respektim të parimeve bazë të ekselencës akademike dhe të vetëqeverisjes, përbëjnë forcën shtytëse për novacion dhe zhvillim ekonomik dhe patjetër që kontribuojnë në lindjen e një shoqërie të hapur. Kjo vlen njësoj, si për vendet e Ballkanit Perëndimor, ashtu edhe për Shtetet Anëtare të BE-së.

Sistemet e shkencës dhe të arsimit të lartë në vendet e Ballkanit Perëndimor duhet **të bëjnë përpjekje për të qenë të hapura**. Ato lipset të zbatojnë procedura ndërkombëtare vlerësimi dhe marrjeje në punë, bashkëpunim dhe konkurrim rajonal dhe ndërkombëtar, të ndjekin metoda të reja kërkimore dhe të përdorin koncepte të reja organizative. Kjo e **ngre besimin te institucionet dhe sistemet**, që është një parakusht për kthimin e kërkuesve shkencorë nga diaspora.

Është me rëndësi të madhe **komunikimi dhe bashkëpunimi i institucionalizuar ndërmjet bashkësisë shkencore dhe vendimmarrësve politikë**, në të gjitha nivelet e qeverisjes. Këshillat kombëtarë këshillimorë për shkencën (ose organizma të ngjashëm) në nivel kombëtar dhe/ose rajonal do ta ndihmonin dialogun e drejtpërdrejtë me ministrat, angazhimin e menjëhershëm nga politika dhe rritjen e subsidiaritetit në administrimin e shkencës.

Besueshmëria është një kusht i domosdoshëm që sistemet shkencore të funksionojnë në mënyrë të efektshme. Qeveritë qendrore duhet **të zbatojnë strategjitë ekzistuese kombëtare dhe rajonale¹ dhe të ratifikojnë marrëveshjet** e lidhura me reformën në shkencë, kërkimin shkencor dhe arsimit të lartë.

Ne, palët pjesëmarrëse, ritheksojmë kërkesën drejtuar qeverive qendrore për arritjen e pragut prej **3% të PBB-së kombëtare si investim në kërkim dhe zhvillim**. Të paktën një e treta e shpenzimeve për kërkim dhe zhvillim duhet të vijë nga buxhetet qendrore. Rekomandohet që ky të jetë një parakusht i detyrueshëm për aderimin në BE.

Kushtet kuadër

Përmirësimet rregullatore çojnë në një mjedis institucional mbështetës që favorizon lirinë kërkimore, shpërblimin e shkencëtarëve në bazë të meritave (për shembull, nëpërmjet negociimit individual), perspektivat afatgjata në karrierë dhe sigurinë në planifikim. Një element kyç i një mjedisi të tillë është ekzistenca e një infrastrukture shkencore adekuate, përfshirë mundësinë për të përdorur buletinet shkencorë, bazat e të dhënave dhe pajisje laboratorike. U kërkohet qeverive të Ballkanit Perëndimor ta mbështesin më tej këtë nëpërmjet **bashkimit të burimeve dhe krijimit të një buxheti të përbashkët të Ballkanit Perëndimor për infrastrukture kërkimore/objekte qendrore të mëdha (të reja)**.

Për cilësi ekselente dhe aftësi konkurruese, thelbësorë janë dy faktorë madhorë: **(i.) autonomia e universiteteve**, e ndërthurur me qeverisje të fortë dhe të pavarur nga ndikimi politik (**depolitizimi**) dhe **(ii.) përkushtimi i një sasive të konsiderueshme kohe për punën kërkimore** nëpërmjet

zvogëlimit të ngarkesës akademike, sidomos në rastin e shkencëtarëve të rinj.

Vlerësimi i detyrueshëm ndërkombëtar i arsimit të lartë, organizatave kërkimore dhe politikave shkencore do të sjellë edhe kushte kuadër të përmirësuara. Në bazë të vlerësimit, në ka konstatime negative, kjo mund të çojë në mbyllje/shkrirje/riformulim të njërive organizative, ndërsa vlerësimet pozitive do ta rrisin prestigjin dhe reputacionin ndërkombëtar. Kërkohet që **ndryshimet në institucionet dhe sistemet shkencore të jenë në përshtatje sipas nevojave të veçanta të një vendi**.

Lëvizshmëria dhe diaspora

Shkenca është një veprimtari ndërkombëtare e cila ka **nevojë për lëvizshmëri**. Lëvizshmëria do të duhej të kuptohej më tej si një **pjesë e vetvetishme e qarkullimit të trurit**. U kërkohet qeverive të vendeve dhe Komisionit të BE-së të hartojnë skema lëvizshmërie që të tërheqin shkencëtarë të shkëlqyer vendas dhe të huaj, si edhe programe të veçanta për diasporën akademike për të nxitur **rikthimin e trurit**. Këto programe duhet të mbështeten vetëm në kritere cilësie. Titullarët e institucioneve kërkimore do të duhej të nxisin përvojën ndërkombëtare dhe rritjen e aftësive si pjesë jetike e shkëmbimit të zyrtarizuar të dijeve.

Kthimi i trurit ka nevojë për një **kulturë mirëpritëse** që e vlerëson plotësisht përvojën ndërkombëtare dhe ofron perspektiva të qëndrueshme karriere. Këtu përfshihen mundësitë për individët e talentuar, si programet me diplomë të dyfishtë të organizuara nga institucione në Ballkanin Perëndimor dhe në vende të huaja, trajnim në grupe kërkimore ndërkombëtare të fjalës së fundit (për shembull të financuara nga Këshilli Evropian për Kërkimin / ERC) me një fazë kthimi gjatë së cilës kërkimi të kryhet në vendet e Ballkanit Perëndimor, emërimet të përbashkëta ose mundësi për shkencëtarët e shquar ndërkombëtarë që të kryejnë kërkim shkencor në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe kështu të trajnojnë kërkuesit e rinj në vend.

Shkencëtarët e rinj

Shkencëtarët e rinj kanë nevojë për mundësi të qëndrueshme në karrierë, përfshirë programe pas studimeve të doktoraturës, të cilat mungojnë në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Prandaj, u kërkohet aktorëve përgjegjës në nivelet politike dhe akademike të garantojnë qarkullimin e informacionit sidomos në lidhje me thirrjet për projekte dhe grante, thirrjet për pjesëmarrje në konferenca, mundësitë për të ecur përpara në karrierë etj. Gjithashtu, duhet t'i mbështetin shkencëtarët e rinj në kërkimin e mundësive në mënyrë institucionale, brenda vendit, në nivel rajonal dhe atë ndërkombëtar.

I nxisim ministratë e vendeve dhe Komisionin e BE-së të krijojnë ose përmirësojnë **fonde dhe programe të veçanta për studiuesit e rinj nga Ballkani Perëndimor** dhe të mbështetin vënien në lidhje dhe në rrjet me sektorët e ekonomisë, sektorin privat, shoqërinë dhe vendimmarrësit.

Qasje novatore

Përmirësimi i qëndrueshëm i kërkimit, shkencës dhe arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor kërkon **qasje novatore nga të gjithë vendimmarrësit**. Për këtë arsye, rekomandojmë që shembujt e praktikës së mirë në Ballkanin Perëndimor të mbështeten dhe ndërliohen në rrjete (rajonale) për të nxitur novacionin (ndryshues) në kërkimin shkencor bazë dhe të aplikuar dhe përhapjen e rrjedhëve pozitive.

¹ Për shembull, Strategjia Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Novacionin (tetor 2013) dhe Strategjia 2020 për Evropën Juglindore (nëntor 2013).

Mund të nxitet kërkimi shkencor i fjalës së fundit nëpërmjet **strategjive progresive**: duke filluar me njësi të vogla organizative (për shembull, qendra të studimeve të avancuara, institute kërkimore të specializuara dhe performuese etj.) dhe duke hartuar projekte të vogla (për shembull në kuadër të Horizon 2020) të cilat, nëse dalin me sukses dhe fitojnë prestigj, mund të zgjerohen.

Ritheksojmë rekomandimin tonë për një numër të vogël të qendrave ndërdisiplinore rajonale (në Ballkanin Perëndimor) **të përqendrimit të njohurive**. Mundësimi i rrjeteve ndërmjet universitetit, sektorëve ekonomikë, qeverisë dhe shoqërisë civile do të mbështetë sipërmarrjen e mbështetur në dije (për shembull, veprimtari anësore apo të reja që burojnë nga rrethet akademike, inkubatorë, qendra të dijeve, grupe ekspertësh etj.) dhe, për pasojë, novacionin në ekonomi dhe në shoqëri.

Kontrolli i cilësisë

Rekrutimi dhe vlerësimi në kërkimin shkencor

Cilësia dhe të dhënat mbështetëse përbëjnë thelbin e veprimtarisë akademike dhe shkencore. Kështu, **proceset e vlerësimit dhe rekrutimit në kërkimin shkencor duhen kryer në mënyrë të rregullt, gjithëpërfshirëse dhe transparente**, në bazë të kriterëve ndërkombëtare të cilësisë të cilat të komunikohen publikisht dhe të jenë të njëtrajtshme. Këto kriterë do të duhej të diferenceshin sipas fushave shkencore madhore dhe të përfshinin jo vetëm kriterë sasiorë por edhe cilësorë.

Kriteret e cilësisë do të duhej të përfshinin publikime në buletine shkencore ku bëhet vlerësim kolegjal dhe të cilat kanë një faktor të lartë ndikimi dhe njohje ndërkombëtare nga bashkësia akademike (për shembull, nëpërmjet citimeve ose punës afruese) si edhe të cilat kanë ndikim në punën kërkimore shkencore dhe në shoqëri. Duhet të jetë e detyrueshme pjesëmarrja e ekspertëve të huaj, krahas atyre vendas, në komisionet përzgjedhëse dhe proceset e vlerësimit.

Financimi i punës kërkimore

Financimi i kërkimit (domethënë përzgjedhja e kërkesave për grant) duhet të mbështetet në parimin e vetëqeverisjes akademike pa asnjë ndërhyrje politike. Prandaj, rekomandojmë fuqimisht **krijimin e institucioneve të pavarura të financimit në vendet e Ballkanit Perëndimor, si këshilla kombëtarë për kërkimin ose fondacione për shkencën** (të ngjashme me FWF¹, DFG², CNRS³ etj.). Kjo kërkon që vendimmarrësit dhe ushtruesit e profesioneve të angazhohen në transferim të dijeve dhe procedurave nga institucionet shembullore. Ritheksojmë rekomandimin tonë për krijimin e një **Fondi Rajonal për Kërkimin Shkencor të Evropës Juglindore (SEERF)** për qëllimet e shpjeguara në këtë deklaratë të përbashkët dhe në Deklaratën I të Përbashkët (2015).

Për të siguruar më shumë pavarësi nga politika, financimi i kërkimit duhet të vijë nga burime që nuk përfshijnë buxhetet qendrore (për shembull, nga biznesi, partneritet publike-private për novacion, grante të huaja etj.). Por qeveritë qendrore duhet të sigurojnë financimin bazë për institutet kërkimore. I nxisim gjithashtu qeveritë e vendeve **të ngrenë programe financimi rezervë për subjekte kërkues që kanë marrë vlerësim të mirë por jo financim nga Këshilli Evropian për Kërkimin**, për të evituar kështu vlerësimin e gjatë dhe të kushtueshëm brenda

vendit. I kërkohet Komisionit Evropian të hartojë **instrumente të posaçme në kuadër të Horizon 2020** për pabarazitë afatgjata në financimin dhe zhvillimin e kërkimit shkencor dhe arsimin të lartë për 6 vendet e Ballkanit Perëndimor dhe BE13.

Administrimi i shkencës

Administrimi qendror dhe institucional i shkencës, përfshirë universitetet dhe njësitë e tjera organizative, duhet të jetë i **profesionalizuar dhe i depolitizuar**. Në organet e administrimit të shkencës dhe në procesin e vendimmarrjes për politikën duhet të përfshihen shkencëtarë të shquar dhe ekspertë akademikë.

Përmirësimi i administrimit të shkencës në të gjitha nivelet institucionale përfshin **sistemet e duhura të mbështetjes** (për shembull zyrë për shërbimet e granteve, të drejtat e pronësisë intelektuale, bashkëpunimi me sektorin ekonomik, komunikimi shkencor etj.), formim për administrimin shkencor, si edhe emërimet si personel i komanduar në administrata të përparuar kërkimore jashtë vendit.

Rekomandojmë që Komisioni Evropian të sigurojë një nyje **unike qendrore informimi** për mundësitë e financimit nga BE dhe të mbështesë masat e ngritjes së kapaciteteve për të eksploruar kërkesat e për projekte në BE.

PALËT PIESËMARRËSE

AKADEMITË KOMBËTARE

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (Muzafer Korkuti) | Akademia Austriake e Shkencave (Anton Zeilinger, Oliver Jens Schmitt) | Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Bosnjë-Hercegovinës (Miloš Trifković) | Akademia Franceze e Shkencave (Bernard Meunier) | Akademia Kombëtare Gjermane e Shkencave “Leopoldina” (Jörg Hacker) | Akademia Italiane “Accademia Nazionale dei Lincei” (Maurizio Brunori) | Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (Nexhat Daci) | Akademia Maqedonase e Shkencave dhe e Arteve (Vlado Matevski) | Akademia Malazeze e Shkencave dhe e Arteve (Momir Đurović) | Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve (Ljubomir Maksimović) | Akademia Sllovene e Shkencave dhe e Arteve (Andrej Kranjc)

KONFERENCAT KOMBËTARE TË REKTORËVE

Konferenca e Rektorëve e Bosnjë-Hercegovinës (Rejhana Dervišević) | Konferenca e Rektorëve e Republikës së Kroacisë (Damir Boras) | Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Kosovë (Marjan Dema) | Konferenca e Universiteteve të Serbisë (Vladimir Bumbaširević) | Konferenca e Rektorëve e Republikës së Sllovenisë (Boris Kavur)

SHKENCËTARË TË SHQUAR DHE EKSPERTË AD PERSONAM

Sanja Bauk (Universiteti i Malit të Zi) | Donald B. Dingwell (Universiteti Ludwig-Maximilians, Mynih) | Dhimitër Doka (Universiteti i Tiranës) | Nemanja Džuverović (Universiteti i Beogradit) | Stipan Jonjić (Universiteti i Riekës) | Erna Karalija (Universiteti i Sarajevës) | Fabjan Lashi (Canadian Institute of Technology, Tiranë) | Almir Maljević (Universiteti i Sarajevës) | Diana Mishkova (Qendra e Studimeve të Avancuara, Sofje) | Artan Puto (Universiteti “Marin Barleti” Tiranë) | Melita Vidaković (Universiteti i Beogradit)

PËRFAQËSUES INSTITUCIONALË

Wolfgang Burtscher (Komisioni Evropian, DP për Kërkim dhe Novacion, Bruksel) | Martin Dietz (Helvetas Swiss Intercooperation, PERFORM, Beograd) | Konstantinos Glinos (Komisioni Evropian, DP për Kërkim dhe Novacion, Bruksel) | Thomas Hesse (Fondacioni “Alexander von Humboldt”, Bon) | Gazmend Turdiu (Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Sarajevë)

1 Fondi Austriak për Shkencën

2 Fondacioni Gjerman për Kërkimin Shkencor

3 Qendra Kombëtare Franceze për Kërkimin Shkencor

Rekomandimet për veprim

Vendimmarrësve në nivel vendi

1. Vlerësimi i shkencës | Dialogu

- a. Të krijohet një këshilli i vetëm kombëtar këshillimor për shkencën (ose një organ i ngjashëm) për çdo vend për të institucionalizuar komunikimin ndërmjet vendimmarrësve të politikave, bashkësisë shkencore dhe përfaqësuesve të shoqërisë dhe ekonomisë.
- b. Të përmbushen deri në fund angazhimet për strategjitë ekzistuese kombëtare dhe rajonale (zbatim në kohën e duhur i tyre, jo vetëm miratim).

2. Kontrolli i cilësisë | Standardet ndërkombëtare

- a. Të ndiqen standardet ndërkombëtare për vlerësimin, rekrutimin dhe akreditimin dhe të përfshihen shkencëtarë të huaj në këto procese.
- b. Të fuqizohet kapaciteti i administrimit të shkencës nëpërmjet instrumenteve të tilla të efektshme si: trajnimi për personelin administrativ, programe diplomimi për administrimin shkencor dhe emërim në periudha të komanduara jashtë vendit.

3. Kultura mirëprirëse | Qarkullimi i trurit | Lëvizshmëria

- a. Të hartohen strategji të përshtatura për rikthimin e trurit për shkencëtarët e shkëlqyer nga diaspora. Nëpërmjet financimit të kërkimit shkencor brenda vendit, të nxiten ata që të kthehen në institucionet prej nga janë larguar dhe të tërhiqen studiuesit e huaj.
- b. Të realizohen programe emërimi të përbashkët/diplomimi të dyfishtë me institucione të huaja.

4. Autonomia | Depolitizimi

- a. Të krijohet një mekanizëm financimi i pavarur (për shembull fondacione kombëtare për kërkimin shkencor) që të ofrojë mundësi afatgjata financimi dhe fonde të posaçme për studiuesit e rinj, mbështetur vetëm në kriteret e ekselencës.
- b. Të ngrihen programe financimi rezervë për subjekte kërkues që kanë marrë vlerësim të mirë por jo financim nga Këshilli Evropian për Kërkimin.
- c. Të sigurohet autonomia e universiteteve për të marrë vendime të pavarura për shpërblimin, shpërndarjen e ngarkesës kërkimore dhe mësimore, prioritetet kërkimore dhe njësitë e mbështetjes shkencore.

5. Zvogëlimi i pabarazive | Bashkëpunimi rajonal

- a. Të përdoren programet ekzistuese mbështetëse të BE-së: për shembull, instrumentet e IPA II për arsimin, kërkimin dhe novacionin, Fondi për Mbështetjen e Politikave dhe "Përhapja e ekselencës dhe zgjerimi i pjesëmarrjes" në Horizon 2020.
- b. Të bashkëpunohet me qeveritë e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor për të bashkuar burimet dhe për të krijuar një buxhet të përbashkët për infrastruktura të mëdha kërkimore dhe financim të përbashkët.

Komisionit Evropian

1. Vlerësimi i shkencës | Dialogu

- a. Të ndërliqen shembujt e praktikës më të mirë nga kërkimi shkencor dhe të nxitet bashkëpunimi shkencë-ekonomi për novacionin në vendet e BP6 dhe BE13.

2. Kontrolli i cilësisë | Standardet ndërkombëtare

- a. Të transferohen njohuritë për administrimin e shkencës.
- b. Të ofrohen seminare pune për shfrytëzimin e vlerësimit dhe kontrollit të cilësisë të kërkimit shkencor.

3. Kultura mirëprirëse | Qarkullimi i trurit | Lëvizshmëria

- a. Të financohen skema lëvizshmëria për qarkullimin e trurit që shkencëtarë të rinj nga Ballkani Perëndimor të punojnë në shoqëri tregtare dhe institucione të fjalës së fundit jashtë vendit.
- b. Të mbështeten programe emërimi të përbashkët/diplomimi të dyfishtë me ndërmjet 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Shteteve Anëtare të BE-së.

4. Autonomia | Depolitizimi

- a. Të vendosen prioritetet për investimet në arsim, kërkim dhe novacion nga IPA II dhe fondet strukturore.
- b. Të fuqizohet rrjeti i pikave kombëtare të kontaktit në mënyrë sistematike dhe të përforcohet qarkullimi i informacionit.

5. Zvogëlimi i pabarazive | Instrumente të përshtatura

- a. Të hartohen instrumente të posaçme në kuadër të Horizon 2020 për 6 vendet e Ballkanit Perëndimor dhe BE13 për të luftuar pabarazitë në financimin dhe zhvillimin e kërkimit shkencor dhe arsimit të lartë.
- b. Të sigurohet një nyje qendrore informimi për mundësitë e financimit nga BE.
- c. Të transferohen njohuritë për përmbushjen e kërkesave të Zonës Evropiane të Kërkimit dhe sfidat e veçanta të vendeve në transformimin e sistemeve kombëtare të kërkimit shkencor dhe novacionit.

28 QERSHOR 2016

DEKLARATË E PËRBASHKËT E KONFERENCËS
II SHKENCORE TË BALLKANIT PERËNDIMOR /
PROCESI I BERLINIT

SQ